



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:272663

Datë: 31.05.2022

Numri i dokumentit: 03076451

P.nr.996/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Veli Kryeziu, me zyrtaren ligjore Fikrije Rexhepi, në çështjen penale ndaj të pandehurit **B.Sh** nga fsh.P., Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale Vjedhje pylli nga neni 349 par.1 i .KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.1921/2020 të datës 02.12.2021, të cilën e përfaqëson prokurorja e shtetit Huma Jetishi, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar më datë 27.05.2021, publikisht shpalli, ndërsa më 27.05.2021, hartoi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **B.Sh** nga i ati B. , e ëma Gj., e lindur Aliu, i lindur më 26.10.1988 , në Gjilan, me vendbanim në fsh.P. , ku edhe jeton i pa punësuar , bujk, me numër personal identifikues:, ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i pa denuar.

Është fajtor

Me datë 28.10.2021, rreth orës 11:00h, në terrenin e fshatit P., Komunë e Gjilanit, në vendin e quajtur "N.", i pandehuri me qëllim vjedhje, në pyllin e pronësisë shoqërore administruar nga A.P.K, zyra në Gjilan, me sharrë motorike ka prerë 51 copa trungje të llojit Bungu, me diametër 14-50 cm, me qëllim të përgjithshëm prej 3.10 metër kub, me çka ka shkatuar dëm në shumë prej 396.80 Euro, shumë kjo për të cilën e ka dëmtuar A.P.K-ën zyra në Gjilan.

-për shkak të veprës penale Vjedhje pylli nga neni 349 par.1.KPRK-së ,

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore si dhe neneve, 4,7,17,38,39,40,43,69,70,71 dhe 72 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të Kodit Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të pandehurin,

E gjykon

Të pandehurin **B.Sh** shqiptohet dënim me gjobë në shumën prej pesëqind (**500**) euro ashtu që dënimi i shqiptuar do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, në pesë rata nga dita pasuese e plotëfuqishëmërisë së këtij aktgjykimi, mirëpo nëse eventualisht i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë në kuptim të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-s i njëjti

I ZËVENDËSOHET me dënim me burgim duke ju llogaritur çdo njëzet 20 euro të barabarta me 1 (një) ditë burgim përkatësisht në kohëzgjatje prej (25) ditë ose në mënyrë përpjesëtimore me pjesën e dënimit të gjobës së pa paguar, të cilin dënim duhet ta filloj ta mbaj në afat prej 15 ditëve nga dita pasuese e pranimit të ftesës nga gjykata.

Pala e demtuar APK ne Gjilan per realizimin e kerkeses pasurore juridike udhzohe ne kontest civil.

I pandehuri **B.Sh** obligohet t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumën prej **20.00 € (njëzet euro)** si dhe taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në shumën prej **tridhjetë (30) euro**, në bazë të nenit 39 paragrafi 3, nën paragrafi 1.3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm në afatin.

A r s y e t i m

1.Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan, me datë 02.12.2021 ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1921/2021, kundër të pandehurit **B.Sh**, për shkak të veprës penalee **Vjedhje e pyllit, nga neni 349 par.1.KPRK-së**. Në shqyrtimin fillestar të datës 27.05.2022, në të cilin ishin prezent Prokurorja e Shtetit Huma Jetishi, i pandehuri **B.Sh**, Në të cilën seancë i pandehuri pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, deklarohet se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurores së shtetit, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit **B.Sh** për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, dhe në konsultim me mbrojtësin e tij, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri **B.Sh** ka kryer veprën penale **Vjedhje pylli nga neni 349 paragrafi 1 i KPRK-së**, në kohën vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Neni 349

Vjedhja e pyllit

- 1. Kushdo që me qëllim të vjedhjes pret trungjet në pyll dhe sasia e druve të prerë tejkalon 2 metra kub, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.**
- 2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet me qëllim të shitjes, ose sasia e druve të prerë tejkalon pesë (5) metra kub, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në katër (4) vjet.**
- 3. Nëse vepra penale nga ky nen kryhet:**
 - 3.1. në pyllin e mbrojtur, në parkun e mbrojtur apo në pyllin tjetër me destinim të posaçëm;**
 - 3.2. me qëllim që drunjtë e prerë të shiten, pavarësisht sasisë së drurit të përfshirë, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.**
- 4. Tentativa për të kryer veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni është e dënueshme.**
- 5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit**

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit, ka vlerësuar se të pandehurit **B.Sh**, t'i shqiptohet dënimi me gjobë ngase ka vlerësuar se duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat e shënuara më poshtë, të cilat duke i ndërlidhur njëra me tjetrën, janë vlerësuar rrethana posaçërisht lehtësuese, ky dënim do të jetë një dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale. Me rastin e matjes së dënimit e të pandehurit, gjykata ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të parashikuara në nenin 69 dhe 71 të KPRK-së, Kështu, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka zbutur dënimin dhe ndaj të pandehurit ka shqiptuar dënim të paraparë me ligje, është fakti se i pandehuri ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, me datë 27.05.2022 ka pranuar fajësin duke i ditur pasojat e pranimin të fajsisë, gjithashtu, si rrethana posaçërisht lehtësuese, gjykata ka marrë dhe faktin se i pandehuri ka bashkëpunuar me prokurorinë e shtetit, se pranimin e fajësisë e ka bërë në të gjitha fazat e procedurës penale, se i pandehuri është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre penale, duke premtuar se kurrë nuk do të përsëris kesi llojë veprash penale, ndërsa rrethanë rënduese është rrezikshmëria e veprës penale.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Gjykata, ka konstatuar se me dënim me gjobë mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurit, gjykata, duke u bazuar në nenin 453 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për ta paguar shpenzimet e procedurës penale, dhe paushallin gjyqësor, si dhe dënimin prej tridhjet eurove për mbrojtjen e viktimave të krimit, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykim

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/
P.nr.996/21, më 27.05.2022

Zyrtare Ligjore

Gjyqtari,

Fikrije Rexhepi

Veli KRYEZIU

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë / Departamentit të përgjithshëm në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimin e të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.